



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 50/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.SH.“Besa-Cola”, - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Dreni-A” Sh.p.k.– Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Shërbimet e transportit me merimangë -Ritender” Lot 2, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Kuvendi i Komunës Prishtinë (KK-Prishtinë), më datën 27.02.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH.“Besa-Cola”, - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e transportit me merimangë -Ritender” Lot 2, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës Prishtinë (KK-Prishtinë).

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Shërbimet e transportit me merimangë -Ritender” Lot 2, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës Prishtinë (KK-Prishtinë).

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.SH.“Besa-Cola”, - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 16.11.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 04.12.2018

Njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm 17.01.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt: 21.01.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 23.01.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.T.SH.“Besa-Cola”, - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 04.02.2019 me nr. 50/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e transportit me merimangë -Ritender” Lot 2, me numër të prokurimit: 616-18-8971-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës Prishtinë (KK-Prishtinë), duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.1 & 9.2 i FDT nenin 7, 39, 59, 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.02.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 19.02.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Neni 9.1 & 9.2 i FDT-së kapacitetet teknike dhe

profesionale sepse ka shpallë të përgjegjshëm për Lot 2 OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesën për përshtatshmërinë profesionale për dy ndihmës punëtorët të cilët njëri nuk e ka kategorinë përkatëse për drejtimin e merimangës, ndërsa për tjetrin fare nuk ka paraqitur patentë shoferë në dokumentet e ofertës, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit edhe në njoftimin për kontratë si dëshmi për këtë pikë është kërkuar:

“kopja e patentë shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës për dy vozitësit dhe kontrata të punës ose para kontrata për dy vozitësit dhe dy ndihmës punëtorët”

Nga kërkesa shihet që nuk është kërkuar patentë shoferit fare për ndihmës punëtorët por është kërkuar vetëm për shoferët. Operatorët ekonomik nuk kanë pasur obligim ti dorëzojnë kopjet e patentë shoferëve për ndihmës punëtorët por vetëm kontratat e punës kanë qenë obliguese për ata. Pra kjo pikë e dosjes së tenderit është plotësuar nga OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 sipas kërkesës. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Neni 9.1 & 9.2 i FDT-së, kapacitetet teknike dhe profesionale lidhur me kërkesën për Listën e automjeteve sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë e nevojshme (librezën e qarkullimit) për automjetin me targa 645-KS-024 por ka bashkangjitur një marrëveshje për dhënie në shfrytëzim të datës 02.07.2018 e cila i referohet një aktivitetit të prokurimit të kaluar dhe nuk ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Lidhur me këtë kërkesë në dosjen e tenderit nuk është kërkuar që nëse automjetet janë në shfrytëzim operatori ekonomik duhet të ofroj marrëveshjen për marrje në shfrytëzim për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është kërkuar që duhet të shkruhet në marrëveshje edhe numri i aktivitetit të prokurimit. Por është kërkuar vetëm që të ofrohet kontrata apo marrëveshja për marrje në shfrytëzim të automjetit. OE fitues e ka ofruar marrëveshjen e lidhur me datën 02.07.2018 për marrjen në shfrytëzim të automjetit me targa 645-KS-024. Si e tillë kjo marrëveshje e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së sepse na ka diskriminuar në kur ka eliminuar ofertën tonë për mungesë të veprimtarisë përkatëse në certifikatën e biznesit për ushtrimin e shërbimeve të transportit me marimangë dhe se gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarim për veprimtarinë e biznesit edhe pse ne në të kaluarën kemi ushtruar këtë veprimtari por ka nxjerrë vendime të ngutshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Gjatë shqyrtimit të ofertës së OE ankues, eksperti shqyrtues konstaton se në ofertën e OE ankues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka qenë e regjistruar në certifikatën e biznesit veprimtaria e kërkuar në dosjen e

tenderit për ushtrimin e shërbimeve të transportit me marimangë. Meqenëse kjo ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, atëherë me të drejtë e ka eliminuar autoriteti kontraktues për mospërbushje të kërkesës bazike të dosjes së tenderit. Regjistrimi i dy veprimtarive me kode 4941 dhe 5221 në certifikatën e biznesit të OE ankues pas procesit të hapjes së ofertave nuk e bënë të përgjegjshme ofertën e OE ankues. Ky regjistrimi i këtyre kodeve ekonomik ka qenë dashur të bëhet para hapjes së ofertave. Sipas nenit 72 pika 3, plotësimi i dokumenteve mundet të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Në këtë rast ka ndodhë regjistrimi i veprimtarive pas dorëzimit të ofertave. Nuk ka pasur diskriminim të OE ankues dhe as shkelje të nenit 7 të LPP-së nga ana e AK-së por eliminim me të drejtë dhe vlerësimi është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së sepse ne kemi qenë me çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë dhe me këtë i është shkaktuar dëme financiare autoritetit kontraktues, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar. Oferta e OE ankues është kualifikuar e pa përgjegjshme sepse nuk e ka pasur veprimtarinë për ushtrimin e shërbimeve të transportit me marimangë siç ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit. Mos plotësimi i këtij kushti e ka bërë të pa përgjegjshme ofertën e OE ankues. Autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar drejtë dhe në përputhje me nenin 60 të LPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit është shpallë i pa përgjegjshëm me të drejtë nga ana e autoritetit kontraktues sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Mungon veprimtaria përkatëse në certifikatën e regjistrimit të biznesit për ushtrimin e shërbimit të kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për pikat e kontestuara nga OE ankues. Pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankues për shkelje të neneve të LPP-së të theksuara në ankesë nuk qëndrojnë. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kryer në përputhje me dispozitat e LPP-së nga ana e autoriteti kontraktues.

Nga kjo që u tha më lartë në përgjigjeje të pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues e **refuzon** ankesa e OE ankues si të pa bazuar dhe në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që **vazhdoj** me lidhjen e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e transportit me merimangë -Ritender” Lot 2 me nr.prokurimi 616-18-8971-211” në bazë të dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.02.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.02.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Uka deklaroj: Fillimisht deklarohe mi pas deklaratës se dorëzuar 04.02.2019 megjithatë desha te ndërli dhem ne 2 pika te kësaj ankese; pika 1. Te kërkesat mbi mundësit teknike ose profesionale AK ka kërkuar qe OE duhet te ofroj dëshmi se ka minimum 2 vozitës dhe 2 ndihmës punëtor, ne rastin konkret OE DRENI-A nuk ka prezantuar patentshoferët për punëtoret ndihmës 1. Argjend Bernica dhe 2. Armend Tahiri

Ne lidhje me këtë rast vlen te ceket se me dt 08.11.2018 nga AK KK-Prishtine kemi pranuar letër standarde për tenderuesin e eliminuar ku si arsyetim kryesor i AK-se është se ndihmë shoferët nuk e kanë patentshoferin me kategorinë përkatëse kriteret i kanë te njëjta, ne na kanë eliminuar nga ky me arsyetimin se nuk i kemi poseduar veprimtarit përkatëse brenda certifikatës se Biznesit edhe pse me dokumente te njëjta kemi kryer shërbimet e transportit te automjeteve për AK- KK Prishtine për 12 vitet e fundit qe nënkupton nga viti 2006-2018. Edhe një pike tjetër kam për te potencuar pika 2 AK te kërkesat mbi mundësit teknike ose profesionale ka kërkuar qe OE te prezantoj listën e automjeteve me dëshmitë : librezat e qarkullimit nëse mjetet janë ne shfrytëzim te prezantohen kontratat origjinale për shfrytëzim si dhe fotot te cilat dëshmojnë kushtet e automjetit bartës, OE DRENI-A edhe ne këtë pike ka dështuar te i përmbushë kërkesat e AK-se pasi qe për Automjetin e dyte ka bashkangjitur një marrëveshje për dhënie ne shfrytëzim te lidhur me DPZ GASHI TOWNING SERVICE me seli ne Peje kjo marrëveshje e datës 02.07.2018 (para shpalljes se njoftimit për kontrate) është e lidhur për AP me numër 616 18 4235 211 lidhur me shërbime te transportit me merimange pra behet fjale për AP i cili tani me është i anuluar. Gjithashtu marrëveshja nuk është dorëzuar ne forme origjinale siç ka qenë e kërkuar nga AK pasi qe shihet qartë se kjo marrëveshje është e printuar nga e-maili i z. Avni Gashi, konstatojmë se kjo marrëveshje nuk ka asnjë lidhshmëri me AP e tanishëm te prokurimit nr 616 -18- 8971-211. Kërkojë nga OSHP te aprovohet kërkesa jon si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Dalipi deklaroj: AK mbështet raportin e ekspertizës dhe kërkon nga paneli që të refuzoj ankesën si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Kurtishaj deklaroj: OE ankues është eliminuar nga AK për shkak që nuk e ka plotësuar një kërkesë të DT-se që ka të bëjë me veprimtarin përkatëse e cila është kërkuar në certifikatën e biznesit për shërbime të transportit me merimangë. OE ankues nuk e ka poseduar këtë veprimtari në certifikatën e biznesit në kohën kur janë dorëzuar ofertat, pas dorëzimit të ofertave OE ankues ka shkuar i ka regjistruar edhe këto 2 veprimtari, një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 72 të LPP-se. Pika 3 kjo ka qenë arsyeja e eliminimit. Mbetem prapa mendimit tim në ekspertizë.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertëve të OSHP-së, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor. Lidhur me pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të neni 9.1 & 9.2 i FDT-së kapacitetet teknike dhe profesionale sepse ka shpallë të përgjegjshëm për Lot 2 OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesën për përshtatshmërinë profesionale për dy ndihmës punëtorët të cilët njëri nuk e ka kategorinë përkatëse për drejtimin e merimangës, ndërsa për tjetrin fare nuk ka paraqitur patentë shoferë në dokumentet e ofertës, Paneli shqyrtues konform konstatimeve të ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit edhe në njoftimin për kontratë si dëshmi për këtë pikë është kërkuar: “kopja e patentë shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës për dy vozitësit dhe kontrata të punës ose para kontrata për dy vozitësit dhe dy ndihmës punëtorët”. Andaj nga këtu shihet se nga kërkesa shihet që nuk është kërkuar patentë shoferit fare për ndihmës punëtorët por është kërkuar vetëm për shoferët. Paneli shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit shihet se operatorët ekonomik nuk kanë pasur obligim të dorëzojnë kopjet e patentë shoferëve për ndihmës punëtorët por vetëm kontratat e punës kanë qenë obliguese për ata. Pra kjo pikë e dosjes së tenderit është plotësuar nga OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 sipas kërkesës. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Neni 9.1 & 9.2 i FDT-së, kapacitetet teknike dhe profesionale lidhur me kërkesën për Listën e automjeteve sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë e nevojshme (librezën e qarkullimit) për automjetin me targa 645-KS-024 por ka bashkangjitur një marrëveshje për dhënie në shfrytëzim të datës 02.07.2018 e cila i referohet një aktivitetit të prokurimit të kaluar dhe nuk ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit,

Paneli shqyrtues konform konstatimeve të ekspertit shqyrtues konstaton se lidhur me këtë kërkesë në dosjen e tenderit nuk është kërkuar që nëse automjetet janë në shfrytëzim operatori ekonomik duhet të ofroj marrëveshjen për marrje në shfrytëzim për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është kërkuar që duhet të shkruhet në marrëveshje edhe numri i aktivitetit të prokurimit. Por është kërkuar vetëm që të ofrohet kontrata apo marrëveshja për marrje në shfrytëzim të automjetit. OE fitues e ka ofruar marrëveshjen e lidhur me datën 02.07.2018 për marrjen në shfrytëzim të automjetit me targa 645-KS-024. Si e tillë kjo marrëveshje e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së sepse na ka diskriminuar në kur ka eliminuar ofertën tonë për mungesë të veprimtarisë përkatëse në certifikatën e biznesit për ushtrimin e shërbimeve të transportit me marimangë dhe se gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarim për veprimtarinë e biznesit edhe pse ne në të kaluarën kemi ushtruar këtë veprimtari por ka nxjerrë vendime të ngutshme. Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton se gjatë shqyrtimit të ofertës së OE ankues, shihet se në ofertën e OE ankues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka qenë i regjistruar në certifikatën e biznesit veprimtaria e kërkuar në dosjen e tenderit për ushtrimin e shërbimeve të transportit me marimangë. Meqenëse kjo ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, atëherë me të drejtë e ka eliminuar autoriteti kontraktues për mos përmbushje të kërkesës bazike të dosjes së tenderit. Regjistrimi i dy veprimtarive me kode 4941 dhe 5221 në certifikatën e biznesit të OE ankues pas procesit të hapjes së ofertave nuk e bënë të përgjegjshme ofertën e OE ankues. Ky regjistrimi i këtyre kodeve ekonomik ka qenë dashur të bëhet para hapjes së ofertave. Sipas nenit 72 pika 3, plotësimi i dokumenteve mundet të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Në këtë rast ka ndodhë regjistrimi i veprimtarive pas dorëzimit të ofertave. Nuk ka pasur diskriminim të OE ankues dhe as shkelje të nenit 7 të LPP-së nga ana e AK-së por eliminim me të drejtë dhe vlerësimi është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së sepse ne kemi qenë me çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë dhe me këtë i është shkaktuar dëme financiare autoritetit kontraktues. Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar. Oferta e OE ankues është kualifikuar e pa përgjegjshme sepse nuk e ka pasur veprimtarinë për ushtrimin e shërbimeve të transportit me marimangë siç ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit. Mos plotësimi i këtij kushti e ka bërë të pa përgjegjshme ofertën e OE ankues. Autoriteti kontraktues në këtë

rast ka vepruar drejtë dhe në përputhje me nenin 60 të LPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit është shpallë i pa përgjegjshëm me të drejtë nga ana e autoritetit kontraktues sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Mungon veprimtaria përkatëse në certifikatën e regjistrimit të biznesit për ushtrimin e shërbimit të kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit, ku sipas kërkesave të FDT-se pika III.2.2 pika I. është kërkuar: Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional , komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e shërbimit të transportit me merimange. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për pikat e kontestuara nga OE ankues.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankues për shkelje të neneve të LPP-së të theksuara në ankesë nuk qëndrojnë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Prishtinë (KK-Prishtinë),
- 1x1 OE- N.T.SH.“Besa-Cola”, - Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.